**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE VORE**
**ZYRA E NOTERISE FIER**
**Notere / Arjana Dodi/**
**Nr. 2140 rep. Nr.645 kol.**

# KONTRATË SHITJE E KOUTES SË KAPITALEVE NË SHOQËRINË SH.P.K. "TUR-TEKSTIL"

Ne Fier, sot me daten 23 tetor 2017, ne Zyren e Noterise, qe ndodhet ne lagjen "Konferenca e Pezes", para meje noteres Arjana Dodi, u paraqiten personalisht :

**PALA SHITËSE :**
**KANER ALTAN**, i datelindjes 08/09/1965, lindur dhe banues ne Torbali Turqi, identifikuar me pasaporte leshuar nga autoritetet turke, me numer U 03384085, me kombesi dhe shtetesi turke, i afte per te kryer veprime juridike, i cili e njeh mire gjuhen shqipe,
Ketu e me poshte cilesuar "Shitesi" ose "Pala shitese",

**PALA BLERËSE:**
**1-AZEM MYFTAR SHATERI,** i datelindjes 29/12/1961, lindur ne Fier dhe banues ne Plyk Fier, shtetas shqiptar, identifikuar me leterjoftimin ID numer G11229020N, i aftë për të kryer veprime juridike,
**2-ELTJON NIKOLLA SUBASHI,** i datelindjes 18/02/1977, lindur ne Fier dhe banues ne Fier lagje "Konferenca e Pezes", shtetas shqiptar, identifikuar me leterjoftimin ID numer h70218061W, i aftë për të kryer veprime juridike,
**3-ARBËR PETRIT ELMAZAJ,** i datelindjes 14/11/1985, lindur ne Patos Fier dhe banues ne Patos, lagje "Naftetari", shtetas shqiptar, identifikuar me leterjoftimin ID numer I51114035L, i aftë për të kryer veprime juridike,
Ketu e me poshte cilesuar "Bleresat" ose "Pala blerese",

**BAZA LIGJORE:**
**1**-Ligji 9901 date 14-04-2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare".
**2**-Vendimi date23/10/2017 i Ortakut te vetem te shoqerise "TUR-TEKSTIL" shpk.

**OBJEKTI I KONTRATES:**
Shitja e kuotave te kapitalit te shoqerise "TUR-TEKSTIL" shpk ne masen 65% nga ana e ortakut te vetem KANER ALTAN dhe blerja e tyre nga bleresat Azem Shateri, Eltjon Subashi dhe Arbër Elmazaj.

**PËRMBAJTJA E KONTRATES:**

Nga verifikimi i statusit ligjor te shoqerise ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit te Bizneseve, vertetohet se Shoqeria "TUR-TEKSTIL" shpk, eshte rregjistruar ne rregjistrin tregetar te

shoqerive tregetare si person juridik, me numer NIPT L42919403F, me ortak te vetem z. KANER ALTAN, pronar ne masen 100% i te gjitha kuotave te kapitalit te shoqerise "TUR-TEKSTIL", me adrese ne Patos, Lagje Grize, rruga Patos-Fier, km 1, prane Albpetrol sh.a.

Kapitali thelemtar i kesaj shoqerie eshte 100 000,ooo leke (njeqindmije), i ndare ne 100 pjese (ose 1 kuote e vetme ne pronesine e ortakut te vetem KANER ALTAN).

Me kete kontrate shitblerje, shitesi KANER ALTAN, u shet bleresave AZEM SHATERI, ELTJON SUBASHI dhe ARBËR ELMAZAJ, nje pjese te kapitalit themeltar te shoqerise qe perfaqeson 65 % (gjshtedhjete e pese perqind) gjithsej, te ndara ne:

- **30%** (tridhjete perqind) te kuotave te kapitalit te shoqerise, ne pronesine e z.ARBËR ELMAZAJ,
- **25%** (njezete e pese perqind) te kuotave te kapitalit te shoqerise, ne pronesine e z.ELTJON SUBASHI,

  dhe
- **10%** (dhjete perqind) te kuotave te kapitalit te shoqerise, ne pronesine e z.AZEM SHATERI.

Shitja e kuotave te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie, ne masen gjithsej 65%, nga ana e ortakut te vetem KANER ALTAN, sjell humbjen e te drejtes se pronesise se tij mbi keto kuota si pasoje e ketij trasanksioni shitje.

Nga ana tjeter bleresat AZEM SHATERI, ELTJON SUBASHI dhe ARBËR ELMAZAJ, jane plotesisht dakort qe te blejne 65% te kuotave te kapitalit te shoqerise, te ndara ne masen 30% per ortakun Arbër Elmazaj, 25% per ortakun Eltjon Subashi dhe 10% per ortakun Azem Shateri.

Pas nenshkrimit te kesaj kontrate, ortake te shoqerise "TUR-TEKSTIL" shpk, do te jene:

1-**KANER ALTAN, me 35% te kuotave te kapitalit** te shoqerise (ose te shprehur ndryshe nje kuote, sipas parimit : Nje anetar – nje kuote),

2-**ARBËR ELMAZAJ, me 30% te kuotave te kapitalit** te shoqerise (ose te shprehur ndryshe nje kuote, sipas parimit : Nje anetar – nje kuote),

3-**ELTJON SUBASHI, me 25% te kuotave te kapitalit** te shoqerise (ose te shprehur ndryshe nje kuote, sipas parimit : Nje anetar – nje kuote),

4-**AZEM SHATERI me 10% te kuotave te kapitalit** te shoqerise (ose te shprehur ndryshe nje kuote, sipas parimit : Nje anetar – nje kuote),

**ÇMIMI I SHITJES: 65 000 LEKE (gjashtedhjete e pesemije) leke te ndara ne:**
**-30 000 leke per ortakun Arbër Elmazaj,**
**-25 000 leke per ortakun Eltjon Subashi,**
**-10 000 leke per ortakun Azem Shateri.**

Kjo vlefte eshte paguar plotesisht para redaktimit te kesaj kontrate, jashte zyres se Noterise kesh ne dore, pa asnje lloj pretendimi nga palet.

**MENYRA E KALIMIT TE PRONESISE SE KUOTAVE:**

Me nenshkrimin e ketij aktì, shitesi e humbet pronesine e tij ne masen 65% ne kuotat e kapitalit te shoqerise, duke mos pasur ne te ardhmen asnje pretendim pronesie mbi keto kuota. Ndersa bleresat ARBËR ELMAZAJ, ELTJON SUBASHI dhe AZEM SHATERI, njihen pronare te ligjshem te ketyre kuotave ne raportin e permendur me siper.

*Per te gjitha te drejtat dhe detyrimet e derisotme qe shoqeria "TUR-TEKSTIL", ka ndaj shtetit, bankave ose te treteve, cilatdo qofshin ato,* ***do te pergjigjet shoqeria "TUR -TEKSTIL", me***

***ortakë KANER ALTAN, ARBËR ELMAZAJ, ELTJON SUBASHI dhe AZEM SHATERI, ne raport me pjesen takuese te secilit ortak ne kapitalin e shoqerise.***

Per sa me siper do te behen ndryshimet perkatese ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit te Bizneseve.

Ky akt pasi lexohet nga palet dhe gjendet prej tyre ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe nenshkruhet ne pese kopje origjinale me vlere te barabarte.

Ne zbatim te ligjit 9887 date 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te dhenave Personale", une noterja deklaroj se do te ruaj dhe perpunoj te dhenat personale te subjekteve te kesaj kontrate, ne menyre te drejte dhe te ligjshme.

Une noterja e vertetoj ne perputhje me nenet 43-51 te ligjit 7829 date 01-06-1994 "Per Noterine" (i ndryshuar).

**P A L E T**

**PALA SHITESE**

Kaner Altan

**PALA BLERESE**

Eltjon Subashi

Arber Elmazaj

Azem Shateri

NOTERE
ARIANA E. DODI

Ariana Dodi